UDHËZIM
Nr. 6, datë 3.2.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 3743, DATË 10.7.2017, "MBI MODELET DHE STANDARDET E BILETAVE TË TRANSPORTIT RRUGOR TË UDHËTARËVE", TË NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 21/2, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar; të pikës 4, të kreut I dhe pikës 3, të kreut III, të vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 3743, datë 10.7.2017, "Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në lidhjen 1, bashkëlidhur udhëzimit, modeli "Biletë transport ndërqytetas", zëvendësohet me modelin "Biletë, në format letër, për transportin rrugor të udhëtarëve në shërbimin ndërqytetas", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MODEL
BILETË, NË FORMAT LETËR, PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË UDHËTARËVE NË SHËRBIMIN NDËRQYTETAS